LIGJ
Nr. 167/2013

PËR RATIFIKIMIN E MARRËVESHJES NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE QEVERISË SË REPUBLIKËS SË INDISË PËR SHMANGIEN E TATIMIT TË DYFISHTË DHE PARANDALIMIN E EVAZIONIT FISKAL PËR TATIMET MBI TË ARDHURAT DHE KAPITALIN

Në mbështetje të neneve 78, 83, pika 1, dhe 121, pika 1, të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Neni 1

Ratifikohet marrëveshja ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës së Indisë për shmangien e tatimit të dyfishtë dhe parandalimin e evazionit fiskal për tatimet mbi të ardhurat dhe kapitalin.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miratuar në datën 31.10.2013

Shpallur me dekretin nr. 8390, datë 14.11.2013 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Bujar Nishani

MARRËVESHJE
NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE QEVERISË SË REPUBLIKËS SË INDISË PËR SHMANGIEN E TATIMIT TË DYFISHTË DHE PARANDALIMIN E EVAZIONIT FISKAL NË LIDHJE ME TATIMET MBI TË ARDHURAT DHE KAPITALIN

Qeveria e Republikës së Indisë dhe Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë, me dëshirën për të nënshkruar një marrëveshje për shmangien e tatimit të dyfishtë dhe parandalimin e evazionit fiskal në lidhje me tatimet mbi të ardhurat dhe kapitalin dhe me qëllim nxitjen e bashkëpunimit ekonomik ndërmjet dy vendeve, kanë rënë dakord si më poshtë:

Neni 1
Personat e përfshirë

Kjo marrëveshje do të zbatohet për persona, të cilët janë rezidentë të një ose të dy shteteve kontraktuese.

Neni 2
Tatimet e përfshira

1. Kjo marrëveshje do të zbatohet për tatimet mbi të ardhurat dhe kapitalin, të vendosura në emër të një shteti kontraktues ose të nënndarjeve politike apo autoriteteve të tij lokale, pavarësisht nga mënyra në të cilën ato janë vendosur.

2. Do të konsiderohen tatime mbi të ardhurat dhe kapitalin të gjitha tatimet e vendosura mbi të ardhurat totale, kapitalin e përgjithshëm ose elemente të të ardhurave apo kapitalit, duke përfshirë tatimet mbi fitimet nga tjetërsimi i pasurisë së luajtshme dhe të paluajtshme dhe tatimet mbi sasitë totale të pagave ose rrogave të paguara nga ndërmarrjet.

3. Tatimet ekzistuese për të cilat zbatohet kjo marrëveshje janë veçanërisht:

a) Në Shqipëri:

i) tatimet mbi të ardhurat (duke përfshirë tatimet e fitimeve të korporatës dhe tatimin individual të të ardhurave);

ii) tatimin mbi aktivitetet e biznesit të vogël; dhe

iii) tatimin e pasurisë;

(në vijim referuar si "tatimet shqiptare").

b) Në Indi:

i) tatimi mbi të ardhurat, duke përfshirë çdo tarifë shtesë mbi to;

ii) tatimi i pasurisë, duke përfshirë çdo tarifë shtesë mbi të;

(në vijim referuar si "tatimet indiane").

4. Marrëveshja zbatohet, gjithashtu, për çdo tatim identik ose thelbësisht të ngjashëm që është vendosur pas datës së nënshkrimit të marrëveshjes, si shtesë ose në vend të tatimeve ekzistuese. Autoritetet kompetente të shteteve kontraktuese njoftojnë njëri-tjetrin në lidhje me çdo ndryshim thelbësor që është bërë në ligjet e tyre përkatëse mbi tatimet.

Neni 3

Përkufizime të përgjithshme

1. Për qëllime të kësaj marrëveshjeje, për sa kohë që konteksti nuk e kërkon ndryshe:

a) Termi "Shqipëria" nënkupton Republikën e Shqipërisë dhe kur përdoret në kuptimin gjeografik, nënkupton territorin e Republikës së Shqipërisë, duke përfshirë ujërat territoriale dhe hapësirën ajrore mbi to, si dhe çdo zonë përtej ujërave territoriale të Republikës së Shqipërisë, e cila sipas ligjeve të saj dhe në përputhje me të drejtën ndërkombëtare, është një zonë brenda së cilës Republika e Shqipërisë mund të ushtrojë të drejtat e saj në lidhje me shtratin e detit, nëntokën dhe burimet e tyre natyrore;

b) Termi "India" nënkupton territorin e Indisë dhe përfshin detin territorial dhe hapësirën ajrore mbi të, si dhe çdo zonë tjetër detare në të cilën India ka të drejta sovrane, të drejta të tjera dhe juridiksion sipas ligjit indian dhe në përputhje me të drejtën ndërkombëtare, duke përfshirë Konventën e OKB-së mbi të drejtën e detit;

c) Termat "shtet kontraktues" dhe "shteti tjetër kontraktues" nënkuptojnë Republikën e Indisë ose Republikën e Shqipërisë, siç e kërkon konteksti;

d) Termi "person" nënkupton një individ, një firmë dhe çdo grup personash dhe ent tjetër, që trajtohet si njësi e tatueshme, sipas ligjeve të tatimit në fuqi në shtetet përkatëse kontraktuese;

e) Termi "firmë" nënkupton çdo organ korporate ose çdo ent që trajtohet si organ korporate për qëllime tatimore;

f) Termi "ndërmarrje" aplikohet për administrimin e çdo biznesi;

g) Termi "ndërmarrje e një shteti kontraktues" dhe "ndërmarrje e shtetit tjetër kontraktues" nënkuptojnë përkatësisht një ndërmarrje të administruar nga një rezident i një shteti kontraktues dhe një ndërmarrje të administruar nga një rezident i shtetit tjetër kontraktues;

h) Termi "trafik ndërkombëtar" nënkupton çdo transport me anije ose avion të operuar nga një ndërmarrje e një shteti kontraktues, përveçse kur anija ose avioni operojnë vetëm midis vendeve në shtetin tjetër kontraktues;

i) Termi "autoritet kompetent" nënkupton:

i) në Shqipëri: Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve, autorizuar nga Ministria e Financave;

ii) në Indi: Ministrinë e Financave, qeverinë e Indisë ose përfaqësuesi i tij i autorizuar;

j) Termi "shtetas" nënkupton:

i) çdo individ që ka kombësinë e një shteti kontraktues;

ii) çdo person juridik, ortakëri ose shoqëri, statusi i të cilave rrjedh si i tillë nga ligjet në fuqi në një shtet kontraktues;

k) Termi "tatim" nënkupton tatimin shqiptar ose indian, siç e kërkon konteksti, por nuk do të përfshijë ndonjë sasi që është e pagueshme në lidhje me ndonjë mospagesë ose mosveprim, në lidhje me tatimet për të cilat zbatohet kjo marrëveshje ose që përfaqëson një dënim ose gjobë të vendosur në lidhje me ato tatime;

l) Termi "vit fiskal" nënkupton:

i) në rastin e Shqipërisë: vitin financiar që fillon më 1 janar;

ii) në rastin e Indisë: vitin financiar që fillon më 1 prill.

2. Për sa i përket zbatimit të marrëveshjes në çdo kohë nga një shtet kontraktues, çdo term i papërkufizuar në të, për sa kohë që konteksti nuk e kërkon ndryshe, ka kuptimin që ka pasur në atë kohë sipas ligjit të atij shteti, për qëllime tatimore për të cilat zbatohet kjo marrëveshje, çdo kuptim sipas ligjeve të zbatueshme tatimore të atij shteti, të cilat kanë përparësi mbi një kuptim të dhënë termit sipas ligjeve të tjera të atij shteti.

Neni 4
Rezidenti

1. Për qëllime të kësaj marrëveshjeje, termi "rezident i një shteti kontraktues" nënkupton çdo person, i cili sipas ligjeve të atij shteti, është përgjegjës për tatimet përkatëse për shkak të banesës së tij, rezidencës, vendit të menaxhimit, vendit të regjistrimit ose çdo kriteri tjetër të një natyre të ngjashme dhe, gjithashtu, përfshin atë shtet dhe çdo nënndarje politike apo autoritet lokal të tij. Megjithatë, ky term nuk përfshin personat që janë përgjegjës për tatimet në atë shtet, në lidhje vetëm me të ardhurat nga burimet në atë shtet ose kapitalin e vendosur në të.

2. Kur për shkak të dispozitave të paragrafit 1, një individ është rezident i të dyja shteteve kontraktuese, atëherë statusi i tij përcaktohet si më poshtë:

a) Ai konsiderohet të jetë rezident vetëm i shtetit në të cilin ka banesën e përhershme në dispozicion; nëse ka banesën e përhershme në dispozicion në të dyja shtetet, ai konsiderohet të jetë rezident vetëm i shtetit me të cilin ka marrëdhënie më të afërta personale dhe ekonomike (qendra e interesave jetësore);

b) Nëse shteti në të cilin ai ka qendrën e interesave të tij jetësore, nuk mund të përcaktohet ose nëse nuk ka banesë të përhershme në dispozicion në secilin shtet, ai konsiderohet të jetë rezident vetëm i shtetit në të cilin ka banesë të përhershme;

c) Nëse ka vendbanim fiks në të dyja shtetet ose në asnjërin prej tyre, ai konsiderohet të jetë rezident vetëm i shtetit nga i cili është shtetas;

d) Nëse është shtetas i të dyja shteteve ose i asnjërit prej tyre, autoritetet kompetente të shteteve kontraktuese do të përpiqen ta zgjidhin çështjen me anë të marrëveshjes së ndërsjellë.

3. Kur për shkak të dispozitave të paragrafit 1, një person i ndryshëm nga një individ, është rezident i të dyja shteteve kontraktuese, atëherë ai konsiderohet të jetë rezident vetëm i shtetit në të cilin ndodhet vendi i menaxhimit të tij efektiv. Nëse shteti në të cilin ndodhet vendi i menaxhimit të tij efektiv, nuk mund të përcaktohet, atëherë autoritetet kompetente të shteteve kontraktuese do të përpiqen ta zgjidhin çështjen me anë të marrëveshjes së ndërsjellë.

Neni 5
Selia e përhershme

1. Për qëllime të kësaj marrëveshjeje, termi "seli e përhershme" nënkupton një vend fiks biznesi

nëpërmjet të cilit administrohet biznesi i një ndërmarrjeje në mënyrë të plotë ose të pjesshme.

2. Termi “seli e përhershme” përfshin në veçanti:

a) një vend menaxhimi;

b) një degë;

c) një zyrë;

d) një fabrikë;

e) një punishte;

f) një magazinë shitjesh;

g) një magazinë në lidhje me një person që siguron ambiente magazinimi për të tjerët;

h) një fermë, plantacion ose vend tjetër ku kryhen aktivitete të ngjashme bujqësore, pylltarie, plantacionesh ose të ngjashme; dhe

i) një minierë, një pus nafte ose gazi, një gurore ose një vend tjetër të nxjerrjes së burimeve natyrore.

3. a) Një shesh ndërtimi, ndërtesë, një projekt instalimi ose montimi, ose aktivitetet mbikëqyrëse në lidhje me to, përbëjnë një seli të përhershme vetëm nëse ky shesh, projekt ose këto aktivitete zgjasin më shumë se gjashtë muaj.

b) Dhënien e shërbimeve, duke përfshirë shërbimet e konsulencës nga një ndërmarrje nëpërmjet punonjësve të saj ose personelit tjetër të përfshirë nga ndërmarrja për atë qëllim, përbën një seli të përhershme, por vetëm kur aktivitetet e asaj natyre vazhdojnë (për të njëjtin projekt ose projekt të ngjashëm) brenda vendit për një periudhë ose periudha që arrijnë në total më shumë se gjashtë muaj brenda çdo periudhe dymbëdhjetëmujore.

4. Pavarësisht nga dispozitat paraardhëse të këtij neni, termi “seli e përhershme” konsiderohet të mos përfshijë:

a) përdorimin e ambienteve vetëm për qëllime magazinimi ose ekspozimi të mallrave që i përkasin ndërmarrjes;

b) mirëmbajtjen e një rezerve mallrash që i përkasin ndërmarrjes vetëm për qëllime magazinimi ose ekspozimi;

c) mirëmbajtjen e një rezerve mallrash që i përkasin ndërmarrjes vetëm për qëllime të përpunimit nga ndërmarrja tjetër;

d) mirëmbajtjen e një vendi fiks biznesi vetëm për qëllime të blerjes së mallrave ose të mbledhjes së informacionit për ndërmarrjen;

e) mirëmbajtjen e një vendi fiks biznesi vetëm për qëllim të vazhdimit nga ana e ndërmarrjes të çdo aktiviteti tjetër të një karakteri përgatitor ose ndihmës;

f) mirëmbajtjen e një vendi fiks biznesi vetëm për çdo kombinim të aktiviteteve të përmendura në nënparagrafët “a” deri “e”, me kusht që aktiviteti i përgjithshëm i vendit fiks të biznesit që rezulton nga ky kombinim, të jetë i një karakteri përgatitor ose ndihmës.

5. Pavarësisht nga dispozitat e paragrafëve 1 dhe 2, kur një person i ndryshëm nga një agjent me status të pavarur për të cilin zbatohet paragrafi 7, vepron në një shtet kontraktues në emër të një ndërmarrjeje të shtetit tjetër kontraktues, ajo ndërmarrje do të konsiderohet të ketë seli të përhershme në atë shtet në lidhje me çdo aktivitet që ai person ndërmerr për ndërmarrjen, nëse ky person:

a) ka ushtruar dhe ushtron zakonisht në atë shtet autoritet për të nënshkruar kontrata në emër të ndërmarrjes, nëse aktivitetet e atij personi nuk kufizohen në ato të përmendura në paragrafin 4, nëse ushtrohen nëpërmjet një vendi fiks biznesi, nuk do ta bënin atë vend fiks biznesi një seli të përhershme sipas dispozitave të atij paragrafi; ose

b) nuk ka autoritet të tillë, përmban zakonisht në shtetin e përmendur me parë një rezervë mallrash nga të cilat ai shpërndan rregullisht mallra në emër të ndërmarrjes; apo

c) jep zakonisht porosi në shtetin e përmendur më parë, tërësisht ose pothuajse tërësisht për vetë ndërmarrjen.

6. Pavarësisht nga dispozitat paraardhëse të këtij neni, një ndërmarrje sigurimesh e një shteti kontraktues, përveçse në lidhje me risigurimin, nuk do të konsiderohet të ketë seli të përhershme në shtetin tjetër kontraktues nëse mbledh prime në territorin e atij shteti tjetër ose jep garanci për rreziqet e

ndodhura në të nëpërmjet një personi të ndryshëm nga një agjent me status të pavarur, për të cilin zbatohet paragrafi 7.

7. Një ndërmarrje nuk do të konsiderohet të ketë një seli të përhershme në një shtet kontraktues thjesht sepse administron biznesin në atë shtet nëpërmjet një ndërmjetësi, agjenti të përgjithshëm komisionesh ose një agjenti tjetër me status të pavarur, me kusht që ata persona të veprojnë gjatë rrjedhës normale të biznesit të tyre. Megjithatë, kur aktivitetet e atij agjenti përkushtohen tërësisht ose pothuajse tërësisht në emër të asaj ndërmarrjeje, ai nuk do të konsiderohet agjent me status të pavarur brenda kuptimit të këtij paragrafi.

8. Fakti që një firmë, e cila është rezidente e një shteti kontraktues kontrollon ose kontrollohet nga një kompani, e cila është rezidente e shtetit tjetër kontraktues ose që administron biznesin në atë shtet tjetër (qoftë nëpërmjet një selie të përhershme ose ndryshe) nuk do të përbëjë në vetvete çdo firmë, seli të përhershme të firmës tjetër.

Neni 6

Të ardhurat nga pasuria e paluajtshme

1. Të ardhurat që rrjedhin nga një rezident i një shteti kontraktues nga pasuria e paluajtshme (duke përfshirë të ardhurat nga bujqësia ose pylltaria) të ndodhura në shtetin tjetër kontraktues, mund të tatohen në atë shtet tjetër.

2. Termi “pasuri e paluajtshme” do të ketë kuptimin që ka sipas ligjit të shtetit kontraktues në të cilin ndodhet prona në fjalë. Në çdo rast, termi do të përfshijë pronën në vartësi të pronës së paluajtshme, gjësë së gjallë dhe pajisjeve të përdorura në bujqësi dhe pylltari, të drejtat për të cilat zbatohen dispozitat e legjislacionit të përgjithshëm në lidhje me tokën në pronësi, uzufruktin e pasurisë së paluajtshme dhe të drejtat për pagesa variable ose fikse, si shpërblim për punën ose të drejtën për të punuar, depozitat minerare, burimet dhe pasuritë e tjera natyrore; anijet, barkat dhe avionët nuk do të konsiderohen si pasuri e paluajtshme.

3. Dispozitat e paragrafit 1 do të zbatohen për të ardhurat që rrjedhin nga përdorimi i drejtpërdrejtë, dhënia me qira ose përdorimi në çdo formë tjetër i pasurisë së paluajtshme.

4. Dispozitat e paragrafëve 1 dhe 3 do të zbatohen, gjithashtu, për të ardhurat nga pasuria e paluajtshme e një ndërmarrjeje dhe për të ardhurat nga pasuria e paluajtshme, të përdorura për realizimin e shërbimeve personale të pavarura.

Neni 7

Përfitimet e biznesit

1. Përfitimet e një ndërmarrjeje të një shteti kontraktues do të tatohen vetëm në atë shtet, për sa kohë që ndërmarrja administron biznesin në shtetin tjetër kontraktues, nëpërmjet një selie të përhershme të vendosur në të. Nëse ndërmarrja administron biznesin siç është përmendur më sipër, përfitimet e ndërmarrjes mund të tatohen në shtetin tjetër, për vetëm për ato që i atribuohen asaj selie të përhershme.

2. Duke iu referuar dispozitave të paragrafit 3, kur një ndërmarrje e një shteti kontraktues administron biznesin në shtetin tjetër kontraktues nëpërmjet një selie të përhershme të vendosur në të, në çdo shtet kontraktues do t’i atribuohen asaj selie të përhershme përfitimet, të cilat mund të pritet të nxjerrë nëse do të ishte një ndërmarrje më vete dhe e ndarë, e përfshirë në aktivitete të njëjta ose të ngjashme, sipas kushteve të njëjta ose të ngjashme dhe që trajtojnë tërësisht në mënyrë të pavarur ndërmarrjen e së cilës është seli e përhershme.

3. Në përcaktimin e përfitimeve të një selie të përhershme, do të lejohen si zbritje, shpenzimet që janë bërë për qëllime të selisë të përhershme, duke përfshirë shpenzimet ekzekutive dhe të përgjithshme administrative të bëra, qoftë në shtetin në të cilin ndodhet selia e përhershme ose diku tjetër, në përputhje me dispozitat dhe në bazë të kufizimeve të ligjeve tatimore të atij shteti. Megjithatë, asnjë zbritje e tillë nuk do të lejohet në lidhje me shumat (nëse ka) të paguara (ndryshe sesa për rimbursimin e shpenzimeve aktuale) nga selia e përhershme për zyrën drejtuese të ndërmarrjes ose ndonjë prej zyrave të tjera të saj,

me anë të pagesave për të drejtat e autorit, honorarëve ose pagesave të tjera të ngjashme në shkëmbim për përdorimin e patentave, ekspertizës apo të drejtave të tjera, me anë të komisionit ose honorarë për shërbime specifike të kryera ose për menaxhimin ose përveçse në rastin e ndërmarrjeve të bankave me anë të interesit mbi paratë e dhëna hua ndaj selisë së përhershme. Po ashtu, nuk do të merret asnjë llogari në përcaktimin e fitimeve të një selie të përhershme për shumat e faturuara (ndryshe sesa për rimbursimin e shpenzimeve aktuale) nga selia e përhershme për zyrën kryesore të ndërmarrjes ose ndonjë prej zyrave të tjera të saj, me anë të pagesave për të drejtat e autorit, honorarëve ose pagesave të tjera të ngjashme në shkëmbim për përdorimin e patentave, ekspertizës ose të drejtave të tjera, ose me anë të komisionit, ose honorarë të tjerë, për shërbime specifike të kryera për menaxhimin ose përveçse në rastin e një ndërmarrje bankare, me anë të interesit mbi paratë e dhëna hua zyrës kryesore të ndërmarrjes ose ndonjë prej zyrave të tjera të saj.

4. Për sa kohë që vendoset normalisht në një shtet kontraktues, të përcaktojë përfitimet që do t'i atribuohen një selie të përhershme mbi bazën e një ndarjeje të përfitimeve totale të ndërmarrjes ndaj pjesëve të saj të ndryshme, asgjë në paragrafin 2 nuk do të përjashtojë atë shtet kontraktues nga përcaktimi i përfitimeve që do të tatohen nga kjo ndarje, siç mund të jetë normale; megjithatë, metoda e ndarjes së miratuar do të jetë e tillë që rezultati të jetë në përputhje me parimet në përmbajtje të këtij neni.

5. Asnjë përfitim nuk do t'i atribuohet selisë së përhershme vetëm për shkak të blerjes nga ai vendqëndrim i përhershëm të mallrave për ndërmarrjen.

6. Për qëllime të paragrafëve të mësipërm, përfitimet që do t'i atribuohen selisë së përhershme, do të përcaktohen me anë të së njëjtës metodë vit pas viti, për sa kohë nuk ka arsye të fortë dhe të mjaftueshme për të kundërtën.

7. Kur përfitimet përfshijnë zërat e të ardhurave që trajtohen ndarazi në nenet e tjera të marrëveshjes, atëherë dispozitat e atyre neneve nuk do të cenohen nga dispozitat e këtij neni.

Neni 8
Trafiku ndërkombëtar

1. Përfitimet nga një ndërmarrje e një shteti kontraktues nga operimi i anijeve ose avionëve në trafikun ndërkombëtar do të tatohen vetëm në atë shtet.

2. Nëse vendi i menaxhimit efektiv të ndërmarrjes detare është në bordin e një anijeje, atëherë do të çmohet të jetë në shtetin kontraktues në të cilin ndodhet porti i destinacionit të anijes ose nëse nuk ka port destinacioni, në shtetin kontraktues në të cilin operatori i anijes është rezident.

3. Përfitimet që rrjedhin nga një ndërmarrje transportimi që është rezidente e një shteti kontraktues me anë të përdorimit, mirëmbajtjes ose dhënies me qira të kontejnerëve (duke përfshirë rimorkiot dhe pajisje të tjera për transportin e kontejnerëve), të përdorur për transportin e mallrave në trafikun ndërkombëtar, do të tatohen vetëm në atë shtet kontraktues nëse kontejnerët nuk përdoren vetëm brenda shtetit tjetër kontraktues.

4. Për qëllime të këtij neni, interesat mbi investimet e lidhura drejtpërdrejt me operimin e anijeve ose avionëve në trafikun ndërkombëtar, do të konsiderohen si përfitime që rrjedhin nga operimi i këtyre anijeve ose avionëve nëse janë pjesë përbërëse për administrimin e një biznesi të tillë dhe dispozitat e nenit 11 nuk do të zbatohen në lidhje me këtë interes.

5. Dispozitat e paragrafit 1 do të zbatohen, gjithashtu, për përfitimet nga pjesëmarrja në një ortakëri, biznes të përbashkët ose një agjenci operuese ndërkombëtare.

Neni 9
Ndërmarrjet e asociuara

1. Në rastet kur:

a) Një ndërmarrje e një shteti kontraktues merr pjesë në mënyrë të drejtpërdrejtë ose jo në menaxhimin, kontrollin ose kapitalin e një ndërmarrjeje të shtetit tjetër kontraktues; ose

b) Kur të njëjtët persona marrin pjesë në mënyrë të drejtpërdrejtë ose jo në menaxhimin, kontrollin ose kapitalin e një ndërmarrjeje të një shteti kontraktues dhe një ndërmarrjeje të shtetit tjetër kontraktues dhe kur në çdo rast, janë përgatitur ose vendosur kushtet midis dy ndërmarrjeve në lidhje me marrëdhëniet e tyre tregtare ose financiare që ndryshojnë nga ato që do të bëheshin midis ndërmarrjeve të pavarura, atëherë çdo fitim që, për shkak të atyre kushteve do t'i ishte shtuar një prej ndërmarrjeve, por për shkak të këtyre kushteve nuk është shtuar, mund të përfshihet në fitimet e asaj ndërmarrjeje dhe për rrjedhojë të tatohet.

2. Kur një shtet kontraktues përfshin në përfitimet e një ndërmarrjeje të shtetit - dhe rrjedhimisht tatimet - fitimet mbi të cilat një ndërmarrje e shtetit tjetër kontraktues është ngarkuar të tatojë në atë shtet tjetër dhe kur përfitimet e përfshira në këtë mënyrë janë fitimet, të cilat do t'i ishin shtuar ndërmarrjes së shtetit të përmendur më parë, nëse kushtet e vendosura midis dy ndërmarrjeve kishin qenë ato që do të ishin vendosur midis ndërmarrjeve të pavarura, atëherë shteti tjetër do të bëjë një rregullim të përshtatshëm të sasisë së tatimeve të vendosura në to mbi ato fitime. Në përcaktimin e këtij rregullimi, duhet t'u kushtohet vëmendje dispozitave të tjera të kësaj marrëveshjeje dhe autoritetet kompetente të shteteve kontraktuese, nëse është e nevojshme, do të konsultohen me njëri-tjetrin.

Neni l0

Dividendët

1. Dividendët e paguar nga një firmë që është rezidente e një shteti kontraktues ndaj një rezidenti të shtetit tjetër kontraktues, mund të tatohen në atë shtet tjetër.

2. Megjithatë, këta dividendë mund të tatohen, gjithashtu, në shtetin kontraktues në të cilin është rezidente firma që paguan dividendët dhe sipas ligjeve të atij shteti, por nëse pronari përfitues i dividendëve është rezident i shtetit tjetër kontraktues, tatimet e vendosura nuk do të tejkalojnë 10 për qind të sasisë bruto të dividendëve në të gjitha rastet e tjera. Ky paragraf nuk do të cenojë tatimin e kompanisë në lidhje me përfitimet nga të cilat paguhen disidentët.

3. Termi "dividendë", siç përdoret në këtë nen, nënkupton të ardhurat nga aksionet e çdo lloji ose të drejta të tjera që nuk janë detyrime borxhi, që marrin pjesë në përfitime, si dhe nga të drejta të tjera korporate, të cilat i nënshtrohen të njëjtit trajtim tatimor, si të ardhurat nga aksionet nga ligjet e shtetit në të cilin firma që bën shpërndarjen është rezidente.

4. Dispozitat e paragrafëve 1 dhe 2 nuk do të zbatohen nëse pronari përfitues i dividendëve, duke qenë rezident i një shteti kontraktues administron biznesin në shtetin tjetër kontraktues në të cilin firma që paguan dividendët është rezidente, nëpërmjet një selie të përhershme të vendosur në të, apo kryen në atë shtet shërbime personale të pavarura nga një bazë fikse të vendosur në të dhe që aksioni në lidhje me të cilin janë paguar dividendët është efektivisht i lidhur me selinë e përhershme ose bazën fikse. Në këtë rast, do të zbatohen sipas rastit dispozitat e nenit 7 ose 14.

5. Kur një firmë, e cila është rezidente e një shteti kontraktues, nxjerr përfitime ose të ardhura nga shteti tjetër kontraktues, ai shtet tjetër mund të mos vendosë ndonjë tatim mbi dividendët e paguar nga firma, përveç rasteve kur këta dividendë i paguhen një rezidenti të atij shteti tjetër ose për sa kohë që aksioni në lidhje me të cilin janë paguar dividendët, është efektivisht i lidhur me seli të përhershme ose një bazë fikse të vendosur në atë shtet tjetër dhe as nuk do t'i nënshtrojë përfitimet e pashpërndara të firmës një tatim mbi përfitimet e pashpërndara të firmës edhe nëse dividendët e paguar ose përfitimet e pashpërndara përbëhen tërësisht ose pjesërisht prej përfitimeve ose të ardhurave të nxjerra në atë shtet tjetër.

Neni 11

Interesi

1. Interesi i nxjerrë në një shtet kontraktues dhe i paguar ndaj një rezidenti të shtetit tjetër kontraktues, mund të tatohet në atë shtet tjetër.

2. Megjithatë, ky interes mund të tatohet në shtetin kontraktues në të cilin ai lind dhe sipas ligjeve të atij shteti, por nëse pronari përfitues i interesit është rezident i shtetit tjetër kontraktues, tatimi i faturuar

në këtë mënyrë nuk do të tejkalojë 10 për qind të shumës bruto të interesit.

3. Pavarësisht nga dispozitat e paragrafit 2, interesi që lind në një shtet kontraktues do të përjashtohet nga tatimi në atë shtet, me kusht që të rrjedhë dhe të zotërohet në mënyrë të dobishme nga:

a) qeveria, një nënndarje politike ose autoritet lokal i shtetit tjetër kontraktues; ose

b) i) në rastin e Shqipërisë, Banka Qendrore e Shqipërisë; dhe

ii) në rastin e Indisë, Banka e Rezervave të Indisë, Banka e Eksport-Importit e Indisë, Banka Kombëtare e Strehimit; ose

c) çdo institucion tjetër, siç mund të bihet dakord herë pas herë ndërmjet autoriteteve kompetente të shteteve kontraktuese nëpërmjet shkëmbimit të letrave.

4. Termi "interes", siç përdoret në këtë nen, nënkupton të ardhurat nga detyrimet e borxhit të çdo lloji, i siguruar apo jo me hipotekë dhe duke mbartur ose jo një të drejtë për të marrë pjesë në përfitimet e debitorit, në veçanti, të ardhurat nga letrat me vlerë qeveritare dhe të ardhurat nga obligacionet dhe dëftesat e borxhit, duke përfshirë primet dhe çmimet që i bashkëlidhen atyre letrave me vlerë, obligacioneve ose dëftesave borxhi. Për qëllim të këtij neni, tarifat e gjobës për vonesë pagese nuk do të konsiderohen si interesa për qëllim të këtij neni.

5. Dispozitat e paragrafëve 1 dhe 2 nuk do të zbatohen nëse pronari përfitues i interesit, duke qenë rezident i një shteti kontraktues, administron biznesin në shtetin tjetër kontraktues në të cilin lind interesi, nëpërmjet një selie të përhershme të vendosur në të ose kryen në atë shtet tjetër shërbime personale të pavarura nga një bazë fikse të vendosur në të dhe detyrimi i borxhit në lidhje me të cilin është paguar interesi, është efektivisht i lidhur me këtë seli të përhershme ose bazë fikse. Në këtë rast, do të zbatohen sipas rastit dispozitat e nenit 7 ose 14.

6. Interesi do të konsiderohet të lindë në një shtet kontraktues kur paguesi është rezident i atij shteti. Megjithatë, kur një person që paguan interesin, qoftë rezident i shtetit kontraktues apo jo, ka në një shtet kontraktues seli të përhershme ose bazë fikse në lidhje me të cilën ka ndodhur mbetja e borxhit mbi të cilën është paguar interesi dhe ky interes përballohet nga kjo seli e përhershme ose bazë fikse, atëherë interesi do të konsiderohet të lindë në shtetin në të cilin ndodhet selia e përhershme ose baza fikse.

7. Kur për shkak të një marrëdhënieje të veçantë midis paguesit dhe pronarit përfitues ose midis të dyve dhe një personi tjetër, sasia e interesit, duke marrë parasysh detyrimin e borxhit për të cilin është paguar, tejkalon shumën, e cila do të ishte rënë dakord nga paguesi dhe pronari përfitues në mungesë të kësaj marrëdhënieje, do të zbatohen dispozitat e këtij neni vetëm për sasinë e përmendur së fundi. Në këtë rast, pjesa e tepërt e pagesave do të mbetet e tatueshme sipas ligjeve të secilit shtet kontraktues, duke u kushtuar vëmendje dispozitave të tjera të kësaj marrëveshjeje.

Neni 12

Pagesat për të drejtat e autorit dhe honorarët për shërbimet teknike

1. Tatimet për licencat ose honorarët për shërbimet teknike që lindin në një shtet kontraktues dhe të paguara ndaj një rezidenti të shtetit tjetër kontraktues, mund të tatohen në atë shtet tjetër.

2. Megjithatë, këto pagesa për të drejtat e autorit ose honorarë për shërbime teknike mund të tatohen, gjithashtu, në shtetin kontraktues në të cilin ato lindin dhe sipas ligjeve të atij shteti, por nëse pronari përfitues i pagesave për të drejtat e autorit ose honorarëve për shërbimet teknike, është rezident i shtetit tjetër kontraktues, tatimi i vendosur nuk do të tejkalojë 10 për qind të shumës bruto të pagesave për të drejtat e autorit ose honorarëve për shërbimet teknike.

3. a) Termi "pagesa për të drejtat e autorit", siç përdoret në këtë nen, nënkupton pagesat e çdo lloji të marra në lidhje me përdorimin ose të drejtën e përdorimit të çdo të drejte autori të veprës letrare, artistike ose shkencore, duke përfshirë filma kinematografikë ose filma apo kaseta të përdorura për transmetime televizive ose radiofonike, çdo patentë, markë tregtare, projekt ose model, plan, formulë sekrete apo proces, për përdorimin ose të drejtën për të përdorur pajisje industriale, tregtare ose shkencore apo për informacion në lidhje me përvojën industriale, tregtare ose shkencore.

b) Termi "honorarët për shërbimet teknike", siç përdoret në këtë nen, nënkupton pagesat e çdo lloji, të ndryshme nga ato të përmendura në nenet 14 dhe 15 të kësaj marrëveshjeje, në lidhje me shërbimet menaxheriale, teknike ose të konsulencës, duke përfshirë sigurimin e shërbimeve të personelit

teknik apo të personelit tjetër.

4. Dispozitat e paragrafëve 1 dhe 2 nuk do të zbatohen nëse pronari përfitues i pagesave për të drejtat e autorit ose honorarëve për shërbimet teknike, duke qenë rezident i një shteti kontraktues, administron biznesin në shtetin tjetër kontraktues në të cilin lindin pagesat për të drejtat e autorit ose honorarët për shërbimet teknike, nëpërmjet një selie të përhershme të vendosur në të ose kryen në atë shtet tjetër shërbime personale të pavarura nga një bazë fikse të vendosur në të dhe e drejta ose pronësia në lidhje me të cilat janë paguar pagesat për të drejtat e autorit ose honorarët për shërbimet teknike, është e lidhur efektivisht me këtë seli të përhershme ose bazë fikse. Në këtë rast, do të zbatohen sipas rastit dispozitat e nenit 7 ose nenit 14.

5. a) Pagesat për të drejtat e autorit dhe honorarët për shërbimet teknike do të konsiderohen të lindin në një shtet kontraktues kur paguesi është rezident i atij shteti, një nënndarjeje politike, një autoriteti lokal ose një rezidenti të atij shteti. Megjithatë, kur personi që paguan pagesat për të drejtat e autorit ose honorarët për shërbimet teknike, qoftë rezident i shtetit kontraktues apo jo, ka në një shtet kontraktues seli të përhershme ose bazë fikse në lidhje me të cilën ka lindur përgjegjësia për të paguar pagesat për të drejtat e autorit ose honorarët për shërbimet teknike dhe këto pagesa për të drejtat e autorit ose honorarë për shërbime teknike përballohen nga kjo seli jo e përhershme ose vend fiks, atëherë këto pagesa për të drejtat e autorit ose honorarë për shërbime teknike do të çmohen të lindin në shtetin kontraktues në të cilin është vendosur selia e përhershme ose vendi fiks.

b) Kur sipas nënparagrafit “a”, pagesat për të drejtat e autorit ose honorarët për shërbimet teknike nuk lindin në një prej shteteve kontraktuese dhe pagesat për të drejtat e autorit kanë lidhje me përdorimin ose të drejtën për të përdorur, të drejtën e pronës ose honorarët për shërbimet teknike kanë lidhje me shërbimet e kryera në një prej shteteve kontraktuese, pagesat për të drejtat e autorit ose honorarët për shërbimet teknike do të konsiderohen të lindin në atë shtet kontraktues.

6. Kur për shkak të një marrëdhënieje të veçantë midis paguesit dhe pronarit përfitues ose midis të dyve dhe një personi tjetër, sasia e pagesave për të drejtat e autorit ose honorarëve për shërbime teknike, duke marrë në konsideratë përdorimin, të drejtën ose informacionin për të cilin ato janë paguar, tejkalon shumën që do të ishte rënë dakord nga paguesi dhe pronari përfitues në mungesë të kësaj marrëdhënieje, do të zbatohen dispozitat e këtij neni vetëm për sasinë e përmendur së fundi. Në këtë rast, pjesa e tepërt e pagesave do të mbetet e tatueshme sipas ligjeve të secilit shtet kontraktues, duke u kushtuar vëmendje dispozitave të tjera të kësaj marrëveshjeje.

Neni 13

Fitimet e kapitalit

1. Fitimet e nxjerra nga një rezident i një shteti kontraktues nga tjetërsimi i pasurisë së paluajtshme të referuar në nenin 6 dhe të ndodhur në shtetin tjetër kontraktues, mund të tatohen në atë shtet tjetër.

2. Fitimet nga tjetërsimi i pasurisë së luajtshme që përbëjnë pjesë të pasurisë së biznesit të një selie fikse, që një ndërmarrje e një shteti kontraktues ka në shtetin tjetër kontraktues ose të një pasurie të luajtshme që ka lidhje me një bazë fikse në dispozicion të një rezidenti të një shteti kontraktues në shtetin tjetër kontraktues, për qëllim të kryerjes së shërbimeve personale të pavarura, duke përfshirë këto fitime nga tjetërsimi i kësaj selie të përhershme (vetëm ose me të gjithë ndërmarrjen) ose të kësaj baze fikse, mund të tatohen në atë shtet tjetër.

3. Fitimet nga tjetërsimi i anijeve ose avionëve që operojnë në trafikun ndërkombëtar ose pasuria e luajtshme që i përket operimit të këtyre anijeve apo avionëve, do të tatohen vetëm në shtetin kontraktues në të cilin tjetërsuesi është rezident.

4. Fitimet nga tjetërsimi i aksioneve në një firmë që është rezidente e një shteti kontraktues mund të tatohen në atë shtet.

5. Fitimet nga tjetërsimi i çdo pasurie të ndryshme nga ajo e referuar në paragrafët paraardhës të këtij neni, do të tatohen vetëm në shtetin kontraktues në të cilin tjetërsuesi është rezident.

Neni 14
Shërbimet personale të pavarura

1. Të ardhurat që rrjedhin nga një individ që është rezident i një shteti kontraktues nga kryerja e shërbimeve profesionale ose aktiviteteve të tjera të pavarura të një karakteri të ngjashëm, do të tatohen vetëm në atë shtet, përveç rrethanave të mëposhtme, kur këto të ardhura mund të tatohen edhe në shtetin tjetër kontraktues:

a) Nëse ai ka një bazë fikse që i vihet rregullisht në dispozicion në shtetin tjetër kontraktues për qëllim të kryerjes së aktiviteteve të tij; në atë rast, vetëm ajo pjesë e të ardhurave që i atribuohet asaj baze fikse mund të tatohet në atë shtet tjetër; ose

b) Nëse qëndrimi i tij në shtetin tjetër kontraktues është për një periudhë ose periudha që arrijnë apo tejkalojnë në total 183 ditë në çdo periudhë dymbëdhjetëmujore, që fillon ose përfundon në vitin fiskal përkatës; vetëm ajo sasi të ardhurash që rrjedh nga aktivitetet e tij të kryera në atë shtet tjetër, mund të tatohet në atë shtet tjetër.

2. Termi "shërbime profesionale" përfshin veçanërisht aktivitetet e pavarura shkencore, letrare, artistike, arsimore ose didaktike, si dhe aktivitetet e pavarura të mjekëve, avokatëve, inxhinierëve, arkitektëve, kirurgëve, dentistëve, revizorëve dhe kontabilistëve.

Neni 15
Shërbimet personale të varura

1. Në bazë të dispozitave të neneve 16, 18, 19, 20 dhe 21, rrogat, pagat dhe shpërblime të tjera të ngjashme që rrjedhin nga një rezident i një shteti kontraktues në lidhje me një punësim, do të tatohen vetëm në atë shtet, nëse puna nuk ushtrohet në shtetin tjetër kontraktues. Nëse puna ushtrohet në këtë mënyrë, ky shpërblim siç rrjedh nga to, mund të tatohet në atë shtet tjetër.

2. Pavarësisht nga dispozitat e paragrafit 1, shpërblimi që rrjedh nga një rezident i një shteti kontraktues në lidhje me një punë të ushtruar në shtetin tjetër kontraktues, do të tatohet vetëm në shtetin e përmendur më parë, nëse:

a) marrësi është i pranishëm në shtetin tjetër për një periudhë ose periudha që nuk tejkalojnë në total 183 ditë në çdo periudhë dymbëdhjetëmujore, që fillon ose mbaron në vitin fiskal përkatës; dhe

b) shpërblimi paguhet nga ose në emër të një punëdhënësi, i cili nuk është rezident i shtetit tjetër; dhe

c) shpërblimi nuk përballohet nga një seli e përhershme ose një bazë fikse që punëdhënësi ka në shtetin tjetër.

3. Pavarësisht nga dispozitat paraardhëse të këtij neni, shpërblimi që rrjedh në lidhje me një punë të ushtruar në një anije ose avion të operuar në trafikun ndërkombëtar nga një ndërmarrje e një shteti kontraktues, mund të tatohet në atë shtet.

Neni 16
Honorarët e drejtuesve

Honorarët e drejtuesve dhe pagesa të tjera të ngjashme, të rrjedhura nga një rezident i një shteti kontraktues, në cilësinë e tij si anëtar i bordit të drejtuesve ose një organi të ngjashëm të një firme, e cila është rezidente e shtetit tjetër kontraktues, mund të tatohen në atë shtet tjetër.

Neni 17
Artistët dhe sportistët

1. Pavarësisht nga dispozitat e neneve 14 dhe 15, të ardhurat që rrjedhin nga një rezident i një shteti kontraktues në rolin e subjektit argëtues si në teatër, film, artist radioje ose televizioni, muzikant apo sportist, nga aktivitetet personale të ushtruara në këtë mënyrë në shtetin tjetër kontraktues, mund të

tatohen në atë shtet tjetër.

2. Kur të ardhurat në lidhje me aktivitetet personale të ushtruara nga një subjekt argëtues ose sportist në cilësinë e tij si i tillë, nuk i shtohen subjektit argëtues ose sportistit, por një personi tjetër, ato të ardhura, pavarësisht nga dispozitat e neneve 7, 14 dhe 15, mund të tatohen në shtetin kontraktues në të cilin ushtrohen aktivitetet e subjektit argëtues apo sportistit.

3. Dispozitat e paragrafëve 1 dhe 2 nuk do të zbatohen për të ardhurat nga aktivitetet e kryera në një shtet kontraktues nga subjekte argëtuese ose sportistë, nëse aktivitetet mbështeten kryesisht nga fondet publike të një ose të dy shteteve kontraktuese ose të nënndarjeve politike ose autoriteteve të tyre lokale. Në këtë rast, të ardhurat do të tatohen vetëm në shtetin kontraktues, në të cilin subjekti argëtues ose sportisti është rezident.

Neni 18

Pensionet

Në bazë të dispozitave të paragrafit 2 të nenit 19, pensionet dhe shpërblime të tjera të ngjashme të paguara ndaj një rezidenti të një shteti kontraktues në lidhje me punësimin e shkuar, do të tatohen vetëm në atë shtet.

Neni 19

Shërbimi qeveritar

1. a) Rrogat, pagat dhe shpërblime të tjera të ngjashme, të ndryshme nga një pension, të paguara nga një shtet kontraktues ose një nënndarje politike, ose një autoritet lokal i tij ndaj një individi në lidhje me shërbimet e kryera për atë shtet ose nënndarje, ose autoritet, do të jenë të tatueshme vetëm në atë shtet.

b) Megjithatë, këto rroga, paga dhe shpërblime të tjera të ngjashme do të tatohen vetëm në shtetin tjetër kontraktues, nëse shërbimet kryhen në atë shtet dhe nëse individi është rezident i atij shteti, që:

i) është shtetas i atij shteti; ose

ii) nuk është bërë rezident i atij shteti vetëm për qëllim të kryerjes së shërbimeve.

2. a) Çdo pension i paguar nga ose prej fondeve të krijuara nga një shtet kontraktues ose nënndarje politike, ose autoritet lokal të tij për një individ në lidhje me shërbimet e kryera në atë shtet ose nënndarje, ose autoritet, do të tatohet vetëm në atë shtet.

b) Megjithatë, ky pension do të tatohet vetëm në shtetin tjetër kontraktues nëse individi është rezident dhe shtetas i atij shteti.

3. Dispozitat e neneve 15, 16, 17 dhe 18 do të zbatohen për rrogat, pagat dhe shpërblime të tjera të ngjashme dhe pensione në lidhje me shërbimet e kryera për një biznes të administruar nga një shtet kontraktues ose nënndarje politike ose autoritet lokal të tij.

Neni 20

Profesorët, mësuesit dhe akademikët

1. Një profesor, mësues ose akademik që është ose ishte rezident i shtetit kontraktues, menjëherë para se të vizitojë shtetin tjetër kontraktues për qëllim të mësimdhënies ose angazhimit në kërkime apo në një universitet, kolegj ose institucion tjetër të ngjashëm, të miratuara në atë shtet tjetër kontraktues, do të përjashtohet nga tatimet në atë shtet tjetër mbi çdo shpërblim për atë mësimdhënie ose kërkim gjatë një periudhe që nuk kalon dy vjet nga data e mbërritjes së tij në atë shtet tjetër.

2. Ky nen do të zbatohet për të ardhurat nga kërkimi vetëm nëse ky kërkim ndërmerret nga individi në interesin publik dhe jo për përfitim kryesisht të ndonjë personi ose personave privatë.

3. Për qëllime të këtij neni, një individ do të konsiderohet të jetë rezident i një shteti kontraktues, nëse ai është rezident në atë shtet në vitin fiskal në të cilin ai viziton shtetin tjetër kontraktues ose në vitin fiskal që vjen menjëherë pas tij.

Neni 21

Studentët

1. Një student që është ose ishte rezident i një prej shteteve kontraktuese, menjëherë para se të vizitojë shtetin tjetër kontraktues dhe që është i pranishëm në atë shtet tjetër kontraktues, vetëm për qëllim të arsimimit ose trajnimit të tij, përveç granteve, huave dhe bursave, do të përjashtohet nga tatimet në atë shtet tjetër mbi:

a) pagesat e bëra atij nga persona që banojnë jashtë atij shteti tjetër për qëllime të mirëmbajtjes, arsimimit ose trajnimit të tij; dhe

b) shpërblimin që ai nxjerr nga puna që ushtron në shtetin tjetër kontraktues, nëse puna ka lidhje të drejtpërdrejtë me studimet e tij.

2. Në lidhje me grantet, huat, bursat dhe shpërblimin nga puna që nuk mbulohet nga paragrafi 1, një student i përshkruar në paragrafin 1, përveç kësaj, do të ketë të drejtë gjatë këtij arsimimi ose trajnimi për të njëjtat përjashtime, lehtësira ose ulje në lidhje me tatimet në dispozicion të rezidentëve të shtetit që ai viziton.

3. Përfitimet e këtij neni do të shtrihen vetëm për atë periudhë kohe që mund të jetë e arsyeshme ose që kërkohet zakonisht për të përfunduar arsimimin ose trajnimin e ndërmarrë, por në asnjë rast ndonjë individ nuk do të ketë përfitimet e këtij neni për më shumë se gjashtë vjet rresht nga data e mbërritjes së tij të parë në atë shtet tjetër.

Neni 22
Të ardhura të tjera

1. Zërat e të ardhurave të një rezidenti të një shteti kontraktues, kudo që lindin, të patrajtuara në nenet paraardhëse të kësaj marrëveshjeje, do të tatohen vetëm në atë shtet.

2. Dispozitat e paragrafit 1 nuk do të zbatohen për të ardhurat e ndryshme nga të ardhurat nga pasuria e paluajtshme, siç përcaktohet në paragrafin 2 të nenit 6, nëse marrësi i këtyre të ardhurave, duke qenë rezident i një shteti kontraktues, administron biznesin në shtetin tjetër kontraktues, nëpërmjet një selie të përhershme të vendosur në të ose kryen në atë shtet tjetër shërbime personale të pavarura nga një bazë fikse të vendosur në të dhe e drejta ose prona, në lidhje me të cilat janë paguar të ardhurat është efektivisht e lidhur me atë seli të përhershme ose bazë fikse. Në këtë rast do të zbatohen sipas rastit dispozitat e nenit 7 ose nenit 14.

3. Pavarësisht nga dispozitat e paragrafit 1, nëse një rezident i një shteti kontraktues nxjerr të ardhura nga burime brenda shtetit tjetër kontraktues në formën e lotarive, enigmave të një fjalëkryqi, garave, duke përfshirë garat e kuajve, lojërat me letra dhe lojëra të tjera të çdo lloji ose lojëra fati ose baste të çfarëdolloj natyre, këto të ardhura mund të tatohen në shtetin tjetër kontraktues.

Neni 23
Kapitali

1. Kapitali i përfaqësuar nga pasuria e paluajtshme e referuar në nenin 6, i zotëruar nga një rezident i një shteti kontraktues dhe i vendosur në shtetin tjetër kontraktues, mund të tatohet në atë shtet tjetër.

2. Kapitali i përfaqësuar nga pasuria e luajtshme që përbën pjesë të pronës së biznesit të një selie të përhershme, të cilin një ndërmarrje e një shteti kontraktues ka në shtetin tjetër kontraktues ose nga pasuria e luajtshme që i përket një baze fikse në dispozicion të një rezidenti të një shteti kontraktues në shtetin tjetër kontraktues, për qëllim të kryerjes së shërbimeve personale të pavarura, mund të tatohet në atë shtet tjetër.

3. Kapitali i përfaqësuar nga anijet dhe avionët e operuar në trafikun ndërkombëtar nga një ndërmarrje e një shteti kontraktues dhe nga pasuria e luajtshme që i përkasin operimit të këtyre anijeve dhe avionëve, do të tatohet vetëm në atë shtet kontraktues.

4. Të gjitha elementet e tjera të kapitalit të një rezidenti të një shteti kontraktues do të tatohen

vetëm në atë shtet.

Neni 24
Eliminimi i tatimit të dyfishtë

Tatimi i dyfishtë do të eliminohet si më poshtë:

1. Në Shqipëri:

a) Kur një rezident i Shqipërisë nxjerr të ardhura ose zotëron kapital që në përputhje me dispozitat e kësaj marrëveshjeje mund të tatohen në Indi, Shqipëria do të lejojë:

i) si zbritje nga tatimi shqiptar mbi të ardhurat e atij rezidenti një shumë të barabartë me tatimin e të ardhurave të paguar në Indi; dhe

ii) si zbritje nga tatimi shqiptar mbi kapitalin e atij rezidenti një shumë të barabartë me tatimin e kapitalit të paguar në Indi.

Megjithatë, kjo zbritje, në çdo rast nuk do të kalojë atë pjesë të tatimit shqiptar mbi të ardhurat ose kapitalin, siç llogaritet para se të jepet zbritja që i atribuohet sipas rastit të ardhurave ose kapitalit që mund të tatohet në Indi.

b) Kur në përputhje me ndonjë dispozitë të marrëveshjes, të ardhurat e nxjerra ose kapitali i zotëruar nga një rezident i Shqipërisë përjashtohet nga tatimi në Shqipëri, gjithsesi, në llogaritjen e shumës së tatimit mbi të ardhurat ose kapitalin që mbetet të këtij rezidenti, mund të marrë parasysh të ardhurat ose kapitalin e përjashtuar.

2. Në Indi:

a) Kur një rezident i Indisë nxjerr të ardhura ose zotëron kapital që në përputhje me dispozitat e kësaj marrëveshjeje mund të tatohen në Shqipëri, India do të lejojë si zbritje nga tatimi mbi të ardhurat ose kapitalin e atij rezidenti, një shumë të barabartë me tatimin e paguar në Shqipëri.

Megjithatë, kjo zbritje, në çdo rast nuk do të kalojë atë pjesë të tatimit siç llogaritet para se të jepet zbritja që i atribuohet sipas rastit, të ardhurave ose kapitalit që mund të tatohet në Shqipëri.

b) Kur në përputhje me ndonjë dispozitë të marrëveshjes, të ardhurat e nxjerra ose kapitali i zotëruar nga një rezident i Indisë përjashtohet nga tatimi në Indi, megjithatë, në llogaritjen e shumës së tatimit mbi të ardhurat ose kapitalin që mbetet të këtij rezidenti, India mund të marrë parasysh të ardhurat ose kapitalin e përjashtuar.

Neni 25
Mosdiskriminimi

1. Shtetasit e një shteti kontraktues nuk do t'i nënshtrohen tatimit në shtetin tjetër kontraktues ose çdo kërkese në lidhje me të që ndryshon ose është më e rreptë sesa tatimi dhe kërkesat përkatëse të të cilave, shtetasit e atij shteti tjetër mund t'i nënshtrohen në të njëjtat rrethana, veçanërisht në lidhje me rezidencën. Pavarësisht nga dispozitat e nenit 1, kjo dispozitë do të zbatohet edhe ndaj personave, të cilët nuk janë rezidentë të një ose të dy shteteve kontraktuese.

2. Tatimi mbi një vendqëndrim të përhershëm që një ndërmarrje e një shteti kontraktues ka në shtetin tjetër kontraktues, nuk do të vendoset në mënyrë më pak të favorshme në atë shtet tjetër, sesa tatimi i vënë mbi ndërmarrjet e atij shteti tjetër që vazhdon të njëjtat aktivitete. Kjo dispozitë, nuk do të interpretohet si detyruese për një shtet kontraktues për t'u dhënë rezidentëve të shtetit tjetër kontraktues çdo zbritje financiare personale, lehtësira dhe ulje për qëllime tatimore, duke marrë parasysh statusin civil ose përgjegjësitë familjare, që u jep rezidentëve të vet. Kjo dispozitë nuk do të interpretohet që të parandalojë një shtet kontraktues nga faturimi i fitimeve të një selie të përhershme që një firmë e shtetit tjetër kontraktues ka në shtetin e përmendur më parë në një nivel tatimi që është më i lartë sesa ai i vendosur mbi fitimet e një firme të ngjashme të shtetit kontraktues të përmendur më parë, as të jetë në konflikt me dispozitat e paragrafit 3 të nenit 7.

3. Përveç rasteve kur zbatohen dispozitat e paragrafit 1 të nenit 9 të paragrafit 7 të nenit 11 ose të paragrafit 6 të nenit 12, interesi, pagesat për të drejtat e autorit dhe disbursime të tjera të paguara nga një

ndërmarrje e një shteti kontraktues ndaj një rezidenti të shtetit tjetër kontraktues, për qëllim të përcaktimit të përfitimeve të tatueshme të kësaj ndërmarrjeje, do të jenë të zbritshme, sipas të njëjtave kushte sikur t'i ishin paguar një rezidenti të shtetit të përmendur më parë. Po ashtu, çdo borxh i një ndërmarrjeje të një shteti kontraktues ndaj një rezidenti të shtetit tjetër kontraktues, për qëllim të përcaktimit të kapitalit të tatueshëm të kësaj ndërmarrjeje, do të jetë i zbritshëm sipas të njëjtave kushte, sikur t'i ishin kontraktuar një rezidenti të shtetit të përmendur më parë.

4. Ndërmarrjet e një shteti kontraktues, kapitali i të cilave zotërohet ose kontrollohet tërësisht ose pjesërisht, ose në mënyrë të drejtpërdrejtë apo jo nga një ose më shumë rezidentë të shtetit tjetër kontraktues, nuk do t'i nënshtrohet asnjë tatimi ose kërkese që lidhet me të në shtetin e përmendur më parë, që është e ndryshme ose më e rreptë sesa tatimi dhe kërkesat e ngjashme të cilave mund t'u nënshtrohen ndërmarrje të ngjashme të shtetit të përmendur më parë.

5. Pavarësisht nga dispozitat e nenit 2, dispozitat e këtij neni zbatohen për tatimet e çdo lloji dhe përshkrimi.

Neni 26

Procedura e marrëveshjes së ndërsjellë

1. Kur një person konsideron se veprimet e një ose të dy shteteve kontraktuese rezultojnë ose do të rezultojnë për të në tatim në mospërputhje me dispozitat e kësaj marrëveshjeje, pavarësisht nga zgjidhjet ose lehtësirat e parashikuara nga legjislacioni i brendshëm i atyre shteteve, mund t'ia paraqesë çështjen e tij autoritetit kompetent të shtetit kontraktues në të cilin është rezident ose nëse çështja e tij trajtohet nën paragrafin 1 të nenit 25, mund t'ua paraqesë autoriteteve kompetente të shtetit kontraktues në të cilin është shtetas. Çështja mund të paraqitet brenda tri vitesh nga njoftimi i parë i veprimit që rezulton në tatimin në mospërputhje me dispozitat e marrëveshjes.

2. Nëse kundërshtimi duket të jetë i justifikuar dhe nëse nuk është në gjendje të arrijë në zgjidhje të kënaqshme, autoriteti kompetent do të përpiqet të zgjidhë çështjen me anë të marrëveshjes së ndërsjellë me autoritetin kompetent të shtetit tjetër kontraktues, me synim shmangien e tatimit që nuk është në përputhje me marrëveshjen. Çdo marrëveshje e arritur do të zbatohet pavarësisht ndonjë afati kohor në legjislacionin e brendshëm të shteteve kontraktuese.

3. Autoritetet kompetente të shteteve kontraktuese do të përpiqen të zgjidhin me anë të marrëveshjes së ndërsjellë çdo vështirësi ose dyshim që lind në lidhje me interpretimin ose zbatimin e marrëveshjes. Ata, gjithashtu, mund të konsultohen së bashku për eliminimin e tatimit të dyfishtë në rastet të cilat nuk janë parashikuar në marrëveshje.

4. Autoritetet kompetente të shteteve kontraktues mund të komunikojnë me njëri-tjetrin në mënyrë të drejtpërdrejtë me qëllim të arritjes së një marrëveshjeje në kuptimin e paragrafëve të mësipërm. Kur duket e këshillueshme, me qëllim arritjen e marrëveshjes për të pasur një shkëmbim verbal të opinioneve, ky shkëmbim mund të bëhet nëpërmjet një komisioni që përbëhet nga përfaqësues të autoriteteve kompetente të shteteve kontraktuese.

Neni 27

Shkëmbimi i informacionit

1. Autoritetet kompetente të shteteve kontraktuese do të shkëmbejnë një informacion të tillë (duke përfshirë dokumentet ose kopjet e vërtetuara të dokumenteve), siç parashikohet të jetë i vlefshëm për zbatimin e dispozitave të kësaj marrëveshjeje ose për administrimin dhe zbatimin e ligjeve të brendshme në lidhje me tatimet e çdo lloji dhe përshkrimi, të vendosura në emër të shteteve kontraktuese ose nënndarjeve të tyre politike ose autoriteteve lokale, për sa kohë që tatimi më poshtë të mos jetë në kundërshtim me marrëveshjen. Shkëmbimi i informacionit nuk kufizohet nga nenet 1 dhe 2.

2. Çdo informacion i marrë sipas paragrafit 1 nga një shtet kontraktues do të trajtohet sekret në të njëjtën mënyrë si informacioni i përftuar sipas legjislacionit të brendshëm të atij shteti dhe do të zbulohet vetëm për personat ose autoritetet (duke përfshirë gjykata dhe organe administrative), që merren me vlerësimin ose mbledhjen, zbatimin ose procedimin në lidhje me përcaktimin e apelit rreth tatimeve të

referuara në paragrafin 1 apo monitorimin sa më sipër. Këta persona ose autoritete do të përdorin informacion vetëm për këto qëllime. Ata mund ta zbulojnë informacionin në procedime seancash gjyqësore me dyer të hapura ose në vendime gjyqësore.

3. Në asnjë rast, dispozitat e paragrafëve 1 dhe 2 nuk do të interpretohen si të tilla që të vendosin mbi një shtet kontraktues detyrimin:

a) për të realizuar masa administrative në mospërputhje me ligjet dhe praktikën administrative të atij shteti kontraktues ose të shtetit tjetër kontraktues;

b) të japin informacion (duke përfshirë dokumente ose kopje të vërtetuara të dokumenteve), që nuk është i përftueshëm sipas ligjeve ose në punën normale të administratës së atij shteti kontraktues apo të shtetit tjetër kontraktues;

c) të japin informacion që do të zbulonte çdo sekret tregtar, biznesi, industrial, tregtar ose profesional, ose proces tregtie apo informacion, zbulimi i të cilit do të ishte në kundërshtim me politikën publike.

4. Nëse informacioni kërkohet nga një shtet kontraktues në përputhje me këtë nen, shteti tjetër kontraktues do të përdorë informacionin e tij, duke mbledhur masa për të marrë informacionin e kërkuar edhe pse ai shtet tjetër mund të mos ketë nevojë për këtë informacion për qëllimet e veta tatimore. Detyrimi në përmbajtje të fjalisë paraardhëse u nënshtrohet kufizimeve të paragrafit 3, por në asnjë rast këto kufizime nuk do të interpretohen që të lejojnë një shtet kontraktues të refuzojë për të dhënë informacion vetëm sepse nuk ka asnjë interes të brendshëm për këtë informacion.

5. Në asnjë rast, dispozitat e paragrafit 3 nuk do të interpretohen që një shtet kontraktues të lejohet të refuzojë të japë informacion vetëm ngaqë informacioni disponohet nga një bankë, institucion tjetër financiar, kandidat ose person që vepron në një agjenci ose në mirëbesim apo që ka lidhje me interesat e pronësisë mbi një person.

Neni 28

Asistenca në mbledhjen e tatimeve

1. Shtetet kontraktuese do të ndihmojnë njëri-tjetrin në mbledhjen e detyrimeve të të ardhurave. Kjo asistencë nuk kufizohet nga nenet 1 dhe 2. Autoritetet kompetente të shteteve kontraktuese, me anë të marrëveshjes së ndërsjellë, mund të zgjidhin mënyrën e zbatimit të këtij neni.

2. Termi “detyrim të ardhurash”, siç përdoret në këtë nen, nënkupton një sasi që është detyrim në lidhje me tatimet e çdo lloji dhe përshkrimi, të vendosura në emër të shteteve kontraktuese ose nënndarjeve të tyre politike ose autoriteteve lokale, për sa kohë që tatimi më poshtë nuk është në kundërshtim me këtë marrëveshje ose me çdo instrument tjetër në të cilin shtetet kontraktuese janë palë, si dhe interesin, gjobat administrative dhe kostot e mbledhjes ose mbrojtjen apo ruajtjen që kanë lidhje me këtë shumë.

3. Kur një detyrim të ardhurash i një shteti kontraktues është i zbatueshëm sipas ligjeve të atij shteti dhe është detyrim i një personi, i cili në atë kohë, sipas ligjeve të atij shteti, nuk mund të parandalonte mbledhjen e tij, ai detyrim të ardhurash, me kërkesë të autoritetit kompetent të atij shteti, do të pranohet për qëllime të mbledhjes nga autoriteti kompetent i shtetit tjetër kontraktues. Ai detyrim të ardhurash do të vilet nga ai shtet tjetër në përputhje me dispozitat e ligjeve të tij të zbatueshme për aplikimin dhe mbledhjen e tatimeve të veta, sikur detyrimi i të ardhurave të ishte detyrim të ardhurash i atij shteti tjetër.

4. Kur një detyrim të ardhurash i një shteti kontraktues është detyrim në lidhje me të cilin ai shtet, sipas ligjit të tij, mund të marrë masa të mbrojtjes apo të ruajtjes, me synim sigurimin e vjeljes së tij, ai detyrim të ardhurash, me kërkesë të autoritetit kompetent të atij shteti, do të pranohet për qëllime të marrjes së masave të mbrojtjes apo të ruajtjes nga autoriteti kompetent i shtetit tjetër kontraktues. Ai shtet tjetër do të marrë masa mbrojtjeje apo ruajtjeje në lidhje me atë detyrim të ardhurash në përputhje me dispozitat e ligjeve të tij, sikur detyrimi i të ardhurave të ishte detyrim të ardhurash i atij shteti tjetër edhe sikur në kohën kur këto masa janë zbatuar, detyrimi i të ardhurave nuk do të ishte i zbatueshëm në shtetin e përmendur më parë ose është detyrim i një personi, i cili ka të drejtë të parandalojë vjeljen e tij.

5. Pavarësisht nga dispozitat e paragrafëve 3 dhe 4, një detyrim të ardhurash i pranuar nga një

shtet kontraktues, për qëllime të paragrafit 3 ose 4, nuk do të jetë në atë shtet objekt i afateve kohore ose t'i jepet prioritet i zbatueshëm ndaj detyrimit të të ardhurave sipas ligjeve të atij shteti, për arsye të natyrës së tij si i tillë. Për më tepër, një detyrim të ardhurash i pranuar nga një shtet kontraktues për qëllime të paragrafit 3 ose 4, nuk do të ketë në atë shtet prioritet të zbatueshëm ndaj atij detyrimi të ardhurash sipas ligjeve të shtetit tjetër kontraktues.

6. Procedimet në lidhje me ekzistencën, vlefshmërinë ose sasinë e detyrimit të të ardhurave të një shteti kontraktues, nuk do të paraqiten para gjykatave ose organeve administrative të atij shteti. Asgjë në këtë nen nuk do të interpretohet sikur të krijojë ose të sigurojë ndonjë të drejtë për këto procedime para ndonjë gjykate ose organi administrativ të shtetit tjetër kontraktues.

7. Kur në çdo kohë pasi është bërë një kërkesë nga një shtet kontraktues, sipas paragrafit 3 ose 4 dhe para se shteti tjetër kontraktues të ketë vjelë dhe ridërguar detyrimin përkatës të të ardhurave shtetit të përmendur më parë, detyrimi përkatës i të ardhurave pushon së qenëri:

a) Në rast të një kërkese sipas paragrafit 3, një detyrim të ardhurash i shtetit të përmendur më parë që është i zbatueshëm sipas ligjeve të atij shteti dhe që është detyrim i një personi, i cili në atë kohë, sipas ligjeve të atij shteti, nuk mund të parandalonte vjeljen e tij; ose

b) Në rast të një kërkese sipas paragrafit 4, një detyrim të ardhurash i shtetit të përmendur më parë, në lidhje me të cilin ai shtet, sipas ligjeve të tij, mund të marrë masa mbrojtjeje ose ruajtjeje, me synim sigurimin e vjeljes së tij, autoriteti kompetent i shtetit të përmendur më parë do të njoftojë menjëherë autoritetin kompetent të shtetit tjetër në lidhje me atë fakt dhe me pëlqimin e shtetit tjetër, shteti i përmendur më parë ose do të pezullojë, ose do të tërheqë kërkesën e tij.

8. Në asnjë rast, dispozitat e atij neni nuk do të interpretohen që të vendosin mbi një shtet kontraktues detyrimin:

a) për të realizuar masa administrative në kundërshtim me ligjet dhe praktikën administrative të atij shteti kontraktues ose shtetit tjetër kontraktues;

b) për të realizuar masa që do të ishin në kundërshtim me politikën publike (*public ordre*);

c) për të dhënë asistencë nëse shteti tjetër kontraktues nuk ka ndjekur të gjitha masat e arsyeshme të mbledhjes ose mbrojtjes apo ruajtjes, sipas rastit, të disponueshme sipas ligjeve të tij apo praktikës administrative;

d) për të dhënë asistencë në ato raste kur barra administrative për atë shtet është dukshëm në përpjesëtim të zhdrejtë me përfitimin që duhet të nxirret nga shteti tjetër kontraktues.

Neni 29
Kufizimi i përfitimeve

1. Përveçse kur parashikohet ndryshe në këtë nen, një person (i ndryshëm nga një individ) që është rezident i një shteti kontraktues dhe që nxjerr të ardhura nga shteti tjetër kontraktues do të ketë të drejtë për të gjitha përfitimet e kësaj marrëveshjeje, të dhëna në mënyrë tjetër rezidentëve të një shteti kontraktues, vetëm nëse ky person është person i kualifikuar, siç përcaktohet në paragrafin 2 dhe plotëson kushtet e tjera të kësaj marrëveshjeje për përftimin e ndonjë prej këtyre avantazheve.

2. Një person i një shteti kontraktues është person i kualifikuar për një vit fiskal vetëm nëse ky person është:

a) ent qeveritar; ose

b) një firmë e inkorporuar në secilin prej shteteve kontraktuese, nëse:

i) kategoria kryesore e aksioneve të saj është e renditur në një bursë të njohur siç përkufizohet në paragrafin 5 të këtij neni dhe tregtohet rregullisht në një ose më shumë bursa të njohura; ose

ii) të paktën 50% e votave të përgjithshme ose vlerës së aksioneve në firmë zotërohet në mënyrë të drejtpërdrejtë ose jo nga një ose më shumë individë, rezidentë të një prej shteteve kontraktuese ose/dhe nga persona të tjerë të inkorporuar në secilin prej shteteve kontraktuese në të paktën 50% e votave të përgjithshme ose vlerës së aksioneve ose interesit përfitues të të cilit zotërohet në mënyrë të drejtpërdrejtë ose jo nga një ose më shumë individë rezidentë të një prej shteteve kontraktuese; ose

c) një ortakëri ose shoqëri personash prej të paktën 50% ose më shumë të interesave përfituese, të të cilave zotërohet nga një ose më shumë individë rezidentë të secilit shtet kontraktues ose/dhe nga persona të tjerë të inkorporuar në secilin prej shteteve kontraktuese, të paktën 50% e votave të përgjithshme ose vlerës së aksioneve ose interesit përfitues të të cilit zotërohet në mënyrë të drejtpërdrejtë ose jo nga një ose më shumë individë rezidentë të shteteve kontraktuese; ose

d) një institucion bamirësie ose ent tjetër i përjashtuar nga tatimet, aktivitetet kryesore të të cilit kryhen në një prej shteteve kontraktuese:

Nëse personat e përmendur më lart të mos kenë të drejtë për përfitimet e marrëveshjes nëse më shumë se 50% e të ardhurave bruto të personit për vitin e tatueshëm është paguar ose është e pagueshme në mënyrë të drejtpërdrejtë ose jo për personat që nuk janë rezidentë të një prej shteteve kontraktuese në formën e pagesave që janë të zbritshme për qëllim të llogaritjes të tatimit të mbuluar nga kjo marrëveshje në shtetin e rezidencës së personit (por duke mos përfshirë pagesën me forcën e armës (*arm's length*) në rrjedhën normale të biznesit për shërbimet ose pasurinë e luajtshme dhe pagesat në lidhje me detyrimet financiare ndaj një banke të bëra në lidhje me një transaksion të bërë me një seli të përhershme të bankës, të ndodhur në një prej shteteve kontraktuese).

3. Dispozitat e paragrafëve 1 dhe 2 nuk do të zbatohen dhe një rezident i një shteti kontraktues do të ketë të drejtë për përfitimet e marrëveshjes në lidhje me një zë të ardhurash që rrjedh nga shteti tjetër, nëse rezidenti administron biznes në mënyrë aktive në shtetin e rezidencës (të ndryshëm nga biznesi i bërjes ose i menaxhimit të investimeve për llogari të vetë rezidentit nëse këto aktivitete nuk janë aktivitete bankare, sigurimesh ose garancish) dhe të ardhurat që rrjedhin nga shtetet e tjera kontraktuese rrjedhin në lidhje me/ose kanë lidhje rastësore me atë biznes dhe që rezidenti përmbush kushtet e tjera të kësaj marrëveshjeje për përftimin e këtyre avantazheve.

4. Megjithatë, një rezidenti të një shteti kontraktues nuk do t'i jepen përfitimet e marrëveshjes nëse autoriteti kompetent i shtetit tjetër kontraktues përcakton se krijimi ose përvetësimi, ose mirëmbajtja e këtij personi dhe kryerja e operacioneve të tij nuk kishin si një prej qëllimeve kryesore përftimin e avantazheve sipas marrëveshjes.

5. Për qëllime të këtij neni, termi "bursë e njohur" nënkupton:

a) në Indi, çdo bursë që njihet sipas ligjit të kontratave (rregullores) të sigurimeve, 1956; dhe

b) çdo bursë tjetër që autoritetet kompetente bien dakord të njohin për qëllime të këtij neni.

6. Pavarësisht ndonjë elementi në përmbajtje të paragrafëve 2 deri 5 më lart, asnjë person nuk do të ketë të drejtë për përfitimet e kësaj marrëveshjeje, nëse punët e tij janë rregulluar në mënyrë të tillë sikur të ishte qëllimi kryesor ose një prej qëllimeve kryesore për të shmangur tatimet për të cilat zbatohet kjo marrëveshje.

Neni 30

Anëtarët e misioneve diplomatike dhe postave konsullore

Asgjë në këtë marrëveshje nuk do të cenojë privilegjet fiskale të anëtarëve të misioneve diplomatike ose postave konsullore, sipas rregullave të përgjithshme të legjislacionit ndërkombëtar ose sipas dispozitave të marrëveshjeve të veçanta.

Neni 31

Hyrja në fuqi

1. Shtetet kontraktuese do të njoftojnë njëri-tjetrin me shkrim nëpërmjet kanaleve diplomatike për përfundimin e procedurave të kërkuara nga ligjet përkatëse për hyrjen në fuqi të kësaj marrëveshjeje.

2. Kjo marrëveshje do të hyjë në fuqi pas njoftimit me shkrim mbi përfundimin e saj, duke iu referuar paragrafit 1 të këtij neni.

3. Dispozitat e kësaj marrëveshjeje do të kenë efekt:

a) në Shqipëri, në lidhje me të ardhurat që rrjedhin ose kapitalin e zotëruar më ose pas datës 1

janar të vitit kalendarik, pas vitit në të cilin marrëveshja hyn në fuqi;

b) në Indi, në lidhje me të ardhurat që rrjedhin ose kapitalin e zotëruar në çdo vit fiskal që fillon më ose pas datës 1 prill, pas vitit kalendarik në të cilën marrëveshja hyn në fuqi.

Neni 32

Përfundimi

Kjo marrëveshje do të mbetet në fuqi për një periudhë kohore të pakufizuar derisa t'i jepet fund nga një shtet kontraktues. Secili shtet kontraktues mund t'i japë fund marrëveshjes nëpërmjet rrugëve diplomatike, duke dhënë një njoftim me shkrim ne lidhje me përfundimin të paktën gjashtë muaj para mbarimit të çdo viti kalendarik që fillon pas skadimit të një periudhe prej pesë vjetësh nga data e hyrjes në fuqi të marrëveshjes. Në këtë rast, marrëveshja do të pushojë së qenëri në fuqi:

a) në Shqipëri, në lidhje me të ardhurat që rrjedhin ose kapitalin e zotëruar më ose pas datës 1 janar të vitit kalendarik pas atij në të cilin është dhënë njoftim i përfundimit;

b) në Indi, në lidhje me të ardhurat që rrjedhin ose kapitalin e zotëruar në çdo vit fiskal më ose pas datës 1 prill, pas vitit kalendarik në të cilin është dhënë njoftimi.

Në dëshmi sa më sipër, të nënshkruarit duke qenë rregullisht të autorizuar, kanë nënshkruar këtë marrëveshje.

Bërë në dy kopje në Nju-Delhi, më 8.7.2013, secila në gjuhën indiane, shqipe dhe angleze, të gjitha tekstet duke qenë njëlloj autentike. Në rast mospërputhjesh midis teksteve, teksti në gjuhën angleze do të ketë përparësi.

Për Këshillin e Ministrave të Republikës së Shqipërisë:	Për Qeverinë e Republikës së Indisë:
(Sh.T. Dr. Fatos Kerciku)	(Dr. Sudha Sharma)
Ambasador i Republikës së Shqipërisë në Nju-Delhi	Kryetare, C.B.D.T.